



KODI I SJELLJES DHE RREGULLORJA E KUVENDIT
PROBLEMATIKA DHE REKOMANDIME



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania

Raporti është realizuar si pjesë e projektit “A parliament with integrity: Code of Conduct and accountability” të mbështetur financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SHBA në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të ISP-së dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kuvendi i RSH është institucioni kryesor kushtetues dhe politik në sistemin tonë qeverisës. Ai përfaqëson sovranitetin e qytetarëve, zgjidhet mbi bazën e zgjedhjeve periodike, mbetet epiqendër e debatit politik dhe është institucioni më i komentuar nga qytetarët, media, shoqëria civile dhe institucionet e tjera. Suksesi i një institucioni nuk matet vetëm nga kompetencat, por edhe nga niveli i integritetit, cilësia e përfaqësimit, besimi publik dhe impakti që ka në progresin e vendit dhe të shoqërisë. Kompetencat e Kuvendit janë të përcaktuara në Kushtetutën e RSH, organizimi dhe funksionimi në Rregulloren e Kuvendit, standardet në Kodin e Sjelljes, si dhe të drejta e përgjegjësi të tjera në Ligji për Statusin e Deputetit dhe akte të tjera.

Vetë institucioni deklaron se integriteti institucional dhe etika parlamentare janë ndër vlerat themelore nga të cilat duhet të udhëhiqet Kuvendi i RSH-së në përmbushje të vizionit dhe misionit të tij¹. Standardet e larta të integritetit dhe llogaridhënies institucionale konsiderohen si sfidë, etalon vlerësues dhe faktorë madhorë që ndikojnë në veprimtarinë parlamentare, por edhe në nivelin e demokracisë parlamentare e më gjerë.² Nga ana tjetër, standardet e transparencës, llogaridhënies, etika dhe integriteti përbëjnë edhe mekanizma thelbësorë në funksion të rolit antikorrupsion të parlamentit, një prej sfidave të rëndësishme që ka Shqipëria në procesin e jetësimit të demokracisë funksionale, shtetit të së drejtës dhe në rrugën e anëtarësimit në BE.

Bazuar në këto tregues, vlerësime dhe pritshmëri gjatë vitit 2023-2024 Instituti i Studimeve Politike (ISP) është angazhuar në monitorimin e standardeve etike dhe aktivitetin parlamentar në kuadër të projektit “*A parliament with integrity: Code of Conduct and accountability*” të mbështetur financiarisht nga programi i Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SHBA në Tiranë. Fokusi kryesor është monitorimi i jetësimit të Kodit të Sjelljes dhe praktikave të ndërlidhura në Rregulloren e Kuvendit. Në kuadër të projektit janë publikuar një broshurë informative për deputetët mbi praktikën e mira të Kodit të Sjelljes dhe Transparencës, (shih <https://isp.com.al/brochure-informative-kodi-i-sjelljes-praktikat-modelet-dhe-standardet-e-integritetit-parlamentar/>), si dhe një

¹ Shih: Plani Strategjik i Kuvendit 2020-2025 miratuar me vendimin nr. 56/2021 të Kuvendit, fq. 7 në linkun <https://web-api.parlament.al/Files/20211025114206vendimi%20dhe%20plani%20strategjik.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 09.05.2024)

² Shih: Background Study: Professional and Ethical Standards for Parliamentarians, fq. 9 cit. në linkun <https://www.osce.org/files/f/documents/7/7/98924.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 09.05.2024)

studim i thelluar mbi problematikat aktuale në legjislacionin dhe aktet e brendshme rregullatore në parlamentin tonë, me rekomandime përkatëse (shih <https://isp.com.al/raport-studimor-kodi-i-sjelljes-dhe-rregullorja-rekomandime-per-kuvendin/>). Gjithashtu është në proces publikimi një tjetër raport plotësues me gjetje, problematika dhe rekomandime, drafti i të cilit mund të ndahet paraprakisht në tryezën e punës më 7 qershor 2024.

Ekspertët e ISP janë përpjekur të fokusohen tek problematikat konkrete që lidhen me jetësimin me integritet dhe standarde të larta të normave të Kodit të Sjelljes, duke i parë ato të ndara me debatet politike dhe bilancin politik të Kuvendit, i cili është aspekt që ISP e mbulon dhe e monitoron paralelisht përmes një angazhimi tjetër prej vitit 2016. Përvoja e gjatë monitoruese ka mundësuar evidentimin e problematikave më të rëndësishme dhe adresimin e rekomandimeve për ndërhyrje.

Në mënyrë të përmbledhur, duke vlerësuar se:

- I. Rekomandimet janë qasje konstruktive në funksion të rolit kushtetues, interesit publik dhe misionit të deklaruar të vetë Kuvendit, për standarde më të larta transparence, llogaridhënie, mirëfunksionimi dhe rritje të besimit publik.
- II. Standardet etike parlamentare ndihmojnë edhe në drejtim të solidaritetit të deputetëve, duke i lejuar ata të kapërcejnë dallimet e dukshme politike dhe të ndërtojnë një frymë bashkëpunimi dhe kolegjaliteti. Ato risin prestigjin e parlamentarit duke ndihmuar në tërheqjen e figurave që kanë integritet të lartë profesional dhe etiko-moral³.

Si dhe duke shprehur gatishmërinë për dhënien e kontributit në kuadër të konsultimeve publike dhe institucionale, **ISP sugjeron:**

- I. Kuvendi, përmes strukturave përgjegjëse të monitorimit dhe vendimmarrjes lidhur me Kodin e Sjelljes dhe Rregulloren e tij, mund të shfrytëzojë momentin (një vit nga përfundimi i legjislaturës) për të

³ Po aty, cit.

trajtuar dhe adresuar të gjitha rekomandimet dhe propozimet e ardhura nga ISP dhe shoqëria civile, nga deputetët dhe burime të tjera, për ndërhyrje përmirësuese gjithëpërfshirëse dhe konsensuale, të cilat mund të hyjnë në fuqi me fillimin e legjislaturës së re. Kjo praktikë (ndryshimet që hyjnë në fuqi në një periudhë tjetër postelektorale) rekomandimet nga Komisioni i Venecias dhe lejon institucionin dhe palët politike të shprehen dhe marrin vendime pa ndikim nga interesat aktuale dhe afatshkurtra politike.

- II. Plotësimet dhe ndryshimet e nevojshme përmirësuese në Kodin e Sjelljes, Rregullore dhe aktet e brendshme rregullatore, duhen shoqëruar edhe me ndryshime në aktet rregullatore të vetë grupeve parlamentare dhe mënyrën sesi funksionojnë ato, te stafet politike dhe ekspertët mbështetës dhe tek pritshmëria publike ndaj tyre.
- III. Ky propozim bazohet edhe në vetë praktikën ligjore të parlamentit, për analiza vjetore të komisioneve dhe analizë të Byrosë së Kuvendit mbi standardet e zbatimit të Kodit të Sjelljes. Po ashtu, Kuvendi i Shqipërisë ka deklaruar me shkrim më 29 mars 2024 mbështetjen institucionale për standardet e transparencës dhe të angazhimit qytetar, në funksion të së cilit janë edhe pjesa më e madhe e rekomandimeve të këtij raporti.

Gjetjet, problematikat dhe rekomandimet konkrete në formë narrative janë pjesë e dy raporteve që mund të aksesohen online dhe falas nga faqja zyrtare e ISP, si dhe vetë ISP do t'i adresojë në formë online dhe print në Kuvend (kabineti i Kryetarit, Sekretari i Përgjithshëm, Sekretariatet përgjegjëse, Grupet parlamentare dhe deputetët e interesuar). Në tabelat vijuese janë paraqitur në formë të përmbledhur në funksion edhe të tryezës së datës 7 qershor 2024.

PROBLEMATIKA DHE REKOMANDIME KONKRETE

KODI I SJELLJES	PROBLEMATIKA	REKOMANDIME
NË LIDHJE ME MONITORIMIN E ZBATIMIT DHE ME VLERËSIMIN PERIODIK TË KODIT TË SJELLJES	<p>Kuvendi, në mbyllje të çdo legjislature, ka detyrimin t'i nënshtrohet vlerësimit të plotë të standardeve etike dhe për ndikimin që këto standarde kanë pasur në punën politike të deputetit (neni 28 i Kodit). Ky vlerësim, i cili nuk është bërë deri më sot, parashikohet të kryhet nga Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin në konsultim me OSHC dhe grupet e interesit që bashkëpunojnë ngushtë me Kuvendin.</p> <p>Që prej miratimit të kodit në vitin 2018 nuk është publikuar asnjë raport vlerësues ose të dhëna për zbatimin e Kodit, rrjedhimisht rëndësia e këtij akti në parandalimin ose uljen e korrupsionit në vend nuk është dokumentuar ende.</p> <p>Sipas Kodit të Sjelljes, Byroja e Kuvendit ka detyrimin e hartimit të raportit vjetor lidhur me rastet e shkeljes së Kodit të Sjelljes si dhe masat disiplinore të marra ndaj deputetëve për këto shkelje. Pavarësisht kësaj, ky parashikim ligjor nuk ka gjetur zbatim.</p>	<ol style="list-style-type: none">a) Në mbyllje të çdo legjislature Kuvendi, në një takim konsultativ me OSHC-të dhe grupet e interesit, të bëjë një vlerësim të plotë të standardeve etike dhe ndikimit që këto standarde kanë pasur në aktivitetin politik të deputetëve me qëllim dokumentimin e rëndësisë së këtij KS në parandalimin ose uljen e korrupsionit në vend.b) Vlerësimi duhet të shoqërohet me rekomandimet përkatëse për votim në seancë plenare.c) Byroja e Kuvendit mund dhe duhet të ushtrojë kompetencat e saj në monitorimin e zbatimit të Kodit të Sjelljes duke përmbushur detyrimin e saj ligjor.d) Rregullorja e Kuvendit duhet ta shtrijë mekanizmin e ankimit edhe ndaj masave të lehta disiplinore.

	Byroja e Kuvendit, ndër të tjera, ushtron edhe funksionet e shqyrtimit të ankesave të deputetëve ndaj masave të rënda disiplinore.	
NË LIDHJE ME RAPORTIN VJETOR TË VEPRIMTARISË SË KUVENDIT	Bazuar në Rregulloren e Kuvendit, Byroja miraton raportin vjetor të veprimtarisë së Kuvendit. Raportet vjetore mbi veprimtarinë e parlamentit ofrojnë një përmbledhje vjetore (me karakter informues) të ushtrimit të funksioneve të parlamentit duke lënë mënjane atë analitik. Raporti i performancës vjetore evidenton sukseset dhe nuk përmend dështimet.	a) Deputetët anëtarë në Byro mund të propozojnë përfshirjen në raport të problematikave të hasura gjatë ushtrimit të funksioneve kushtetuese të Kuvendit me rekomandimet përkatëse, analizë për shkallën e zbatueshmërisë së legjislacionit të miratuar, efektivitetin e ushtrimit të funksioneve përfaqësues, legjislativ dhe mbikëqyrës si dhe shkallën e bashkëpunimit ndërinstucional.
NË LIDHJE ME KOMPETENCËN E KËSHILLIT PËR RREGULLOREN, MANDATET DHE IMUNITETIN PËR INTERPRETIMIN E DISPOZITAVE TË KODIT TË SJELLJES	Referuar dispozitave të Kodit të Sjelljes çdo deputet mund t'i paraqesë kërkesë me shkrim Këshillit për Rregulloren, Mandatit dhe Imunitetin për të bërë interpretim të dispozitave të Kodit. Nga monitorimi Këshilli nuk është mbledhur asnjëherë për të ushtruar këtë kompetencë. Kodi duhet të jetë objekt i interpretimit, zbatimit dhe debatit të vazhdueshëm në përputhje me nevojat dhe ndryshimet në diskursin publik. Këtij qëllimi i shërben edhe vlerësimi i standardeve etike të Kodit në fund të çdo legjislature.	a) Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin mund dhe duhet të angazhohet në interpretimin e dispozitave të Kodit të Sjelljes të cilat lënë hapësira për interpretime të ndryshme apo krijojnë paqartësi. Interpretimi është i nevojshëm pasi ndihmon edhe Byronë e Kuvendit në zbatimin dhe trajtimin e çështjes në të ardhmen.
LIDHUR ME PËRGJEGJËSINË E JETËSIMIT TË KODIT TË SJELLJES	Sipas Kodit të Sjelljes Byroja është autoriteti përgjegjës për zbatimin e rregullave të sjelljes, çfarë nënkupton edhe dhënien e masave disiplinore. Po ashtu Udhëzuesi i Detajuar për Sjelljen në Kuvend ia referon Byrosë së Kuvendit kompetencën për dhënien e sanksioneve, ndërkohë që dispozitat e Rregullores njohin drejtuesin e seancës plenare , drejtuesin e mbledhjes së organit parlamentar ku deputeti merr pjesë dhe Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën si organe përgjegjëse për dhënien e sanksioneve	a) Kuvendi mund dhe duhet të qartësojë subjektet që kanë kompetencë në dhënien e sanksioneve ndaj deputetëve që shkelin rregullat e sjelljes në Kuvend (Byroja e Kuvendit vs Sekretariati për Etikën vs drejtuesi i seancës apo drejtuesi i organit parlamentar).

<p>NË LIDHJE ME SHKELJET E KODIT TE SJELLJES</p>	<p>Rregullorja nuk parashikon sanksione në rastet e shkeljes së rregullave lidhur me: veprimtarinë e jashtme të deputetit, konfliktit të interesave që lidhen me vendimmarrjen e deputetit, kufizimet pas përfundimit të mandatit, përdorimit të pasurive dhe burimeve materiale të Kuvendit për nevoja vetjake, marrëdhëniet e deputetit me Stafin politik dhe Shërbimet e Kuvendit apo edhe në rastin e shkeljes së parimeve dhe vlerave të Kodit</p>	<p>a) Rregullorja e Kuvendit, si akti që parashikon masat disiplinore ndaj deputetit për shkelje të rregullave të Kodit të Sjelljes, mund dhe duhet të parashikojë masë disiplinore për të gjitha rastet e shkeljes së rregullave të parashikuara në Kod.</p>
<p>LIDHUR ME KONFLIKTIN E INTERESIT</p>		
<p>NË LIDHJE ME KONFLIKTIN E INTERESIT</p>	<p>Deputeti mbart detyrimin e deklarimit edhe të të dhënave që rezultojnë nga formulari i interesave private të tij si: emrin e individit, personit fizik ose juridik me të cilin deputeti ka pasur marrëdhënie juridiko-civile kontraktuale ose çdo marrëdhënie tjetër me individë ose subjekte që ka pasur si pasojë gjenerimin e të ardhurave për deputetin dhe që përbën konflikt të vazhdueshëm dhe; të drejtat mbi kapitalin e shoqërive tregtare të zotëruara nga bashkëshorti/bashkëjetuesi, fëmijët e rritur dhe prindërit e deputetit dhe që mund të përbëjnë kufizim në veprimtari tregtare.</p> <p>Deklarimi i këtyre të dhënave, referuar rregullave të sjelljes, duhet të jetë pjesë e Regjistrit të Konfliktit të Interesit i cili publikohet. Pavarësisht detyrimit ligjor, ky regjistër përmban vetëm 14 rastet që lidhen me vendimmarrjen e deputetit dhe nuk përfshin të dhënat e mësipërme.</p>	<p>a) Kuvendi, mund dhe duhet të organizojë dhe publikojë Regjistrin e konfliktit të interesave sipas përcaktimeve të miratuara nga Byroja e Kuvendit në Udhëzuesin e Detajuar të Sjelljes në Kuvend.</p> <p>b) Kodi i Sjelljes mund dhe duhet të krijojë mekanizma për t'u ardhur në ndihmë deputetëve kur ata janë në dilemë nëse ndodhen apo jo në situata që përbëjnë konflikt interesi. Ndihma mund të konsistojë në këshilla ose udhëzime.</p>

<p>NË LIDHJE ME GJYKIMIN E RASTEVE TË KONFLIKTIT TË INTERESIT QË BIEN MBI DEPUTETIN/PERSONAT E LIDHUR ME TË (PAPAJTUESHMËRIA ME MANDATIN)</p>	<p>Referuar legjislacionit, deputetit nuk i lejohet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. të ushtrojë detyrë tjetër shtetërore, përveç asaj të anëtarit të Këshillit të Ministrave; 2. të kryejë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojë pasuri të këtyre; 3. të jetë drejtues ose anëtar i organeve drejtuese të organizatave fitimprurëse; 4. të ushtrojë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, profesione të lira të avokatisë, të noterisë, ekspertit të licensuar, si dhe të konsulentit, agjentit a përfaqësuesit të organizatave fitimprurëse dhe; 5. nuk mund të jetë i punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër; 6. të zotërojë, në mënyrë aktive, asnjë aksion ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, nëse ajo rezulton me pozitë dominuese në treg. <p>Gjykata Kushtetuese ka juridiksion vetëm për rastet e vlerësimit të papajtueshmërisë me mandatin për shkelje të pikës 2 . Për rastet e tjera të mësipërme nuk parashikohet se cili institucion ka kompetencën për shqyrtimin/gjykimin e rasteve të tjera të konfliktit të interesit sidomos rastet që bien mbi personat e lidhur me deputetin.</p>	<p>a) Kuvendi mund dhe duhet të bëjë plotësimet e nevojshme ligjore për të parashikuar organin kompetent që do të shqyrtojë rastet e tjera të konfliktit të interesit sidomos rastet që bien mbi personat e lidhur me deputetin.</p>
<p>NË LIDHJE ME KUFIZIMET PAS</p>	<p>Kodi parashikon shtrirjen e kufizimeve për një periudhë 1 vjeçare, duke filluar nga dita e mbarimit të mandatit të deputetit. Pas kësaj periudhe ish deputeti lirohet nga çdo lloj kufizimi.</p>	<p>a) Kuvendi mund të hartojë rregulla edhe më të qarta për kufizimet pas periudhës së punësimit të shoqëruara me një mekanizëm efektiv zbatimi për deputetin. Kjo do të forcojë tërësinë e rregullave që</p>

<p>PËRFUNDIMIT TË MANDATIT</p>	<p>Ndërkohë që Kodi vendos kufizime ai nuk parashikon (në këtë rast) një mekanizëm efektiv zbatimi. Kodi duhet të përfshijë dispozita dhe procedura të mirëpërcaktuara për tu siguruar që rregullat e vendosura zbatohen në mënyrë adekuate.</p>	<p>garantojnë integritetin e figurës së deputetit. Është e nevojshme të parashikohen mekanizmat e monitorimit për të siguruar efektivitetin e sistemit të ndalimit.</p> <p>b) Kuvendi mund të vendosë kufizime për ish ligjvënësit edhe kur ata angazhohen në veprimtari lobuese profesionale ose përfaqësuese të lidhura drejtpërsëdrejti me procesin vendimmarrës të Kuvendit. Kjo synon të parandalojë ish-deputetët që të përdorin lidhjet dhe njohuritë e tyre të brendshme për të ndikuar në mënyrë të padrejtë në vendimmarrje dhe në këtë mënyrë të mbrohet interesi publik.</p>
<p>REGJISTRI I DHURATAVE</p>		
<p>NË LIDHJE ME DEKLARIMIN E DHURATAVE</p>	<p>Nuk ka asnjë rast deklarimi nga ana e deputetëve për dhuratat që marrin në veprimtari të ndryshme parlamentare.</p>	<p>a) Kodi i Sjelljes duhet të plotësohet me udhëzime edhe më konkrete për zbatimin e tij në lidhje me dhuratat. Rregullat mbi pranimin dhe deklarimin e dhuratave nga deputetët duhet t'i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe zbatimit të duhur.</p> <p>b) Vlerësimi dhe inventarizimi i dhuratave, të cilat do të përdoren për qëllime të veprimtarisë së institucionit duhet të disiplinohen me Urdhër të Brendshëm të Sekretarit të Përgjithshëm. E njëjta vlen edhe për dhuratat, që për shkak të vlerave muzeale apo</p>

		<p>historike, duhet tu dorëzohen institucioneve të specializuara.</p> <p>c) Kuvendi mund dhe duhet të ekspozojë dhuratat e pranuar, në veçanti ato me vlerë artistike dhe kulturore, në një mjedis të veçantë dhe të qasshëm nga palët dhe publiku.</p> <p>d) Regjistri i dhuratave mund dhe duhet të publikohet në faqen e Kuvendit në internet në një mënyrë lehtësisht të aksesueshme për publikun.</p>
<p>NË LIDHJE ME DEKLARIMIN E PËRFITIMEVE TË TJERA TË NGJASHME</p>	<p>Deputeti kur merr pjesë në veprimtari të organizuara nga të tretë dhe pjesëmarrja e tij (shpenzimet e udhëtimit, strehimit dhe të qëndrimit) mbulohen prej palës pritëse ose të tretëve, duhet të deklarojë udhëtimet dhe akomodimet e sponsorizuara si dhe dietat e shpenzimet e ofruara.</p> <p>Kjo çështje ka gjetur disiplinim për të shmangur abuzimet, shpenzimet e panevojshme apo keqpërdorimet, veçanërisht për përfitime politike apo personale të deputetit si dhe për të rritur besimin e publikut tek parlamenti.</p> <p>Në praktikë, vetëm 4 deputetë që i përkasin legjislaturës së kaluar kanë bërë këtë deklaram.</p>	<p>a) Në respektim të detyrimit ligjor, deputeti, në rastet e pjesëmarrjes në veprimtari të organizuara nga të tretë, mund dhe duhet të bëjë publike udhëtimet dhe akomodimet e sponsorizuara si dhe dietat e shpenzimet e ofruara prej tyre.</p>
	<p>Të dhënat monitoruese tregojnë se deputetët që angazhohen në veprimtari joparlamentare janë të shumtë por asnjëherë</p>	<p>a) Kuvendi mund dhe duhet të bëjë publike veprimtaritë joparlamentare të çdo deputeti. Në këtë mënyrë,</p>

<p>NË LIDHJE ME VEPRIMTARITË JOPARLAMENTARE TË DEPUTETIT</p>	<p>nuk i janë drejtuar Byrosë së Kuvendit nëse kjo veprimtari përbën konflikt të mundshëm interesi. Njëkohësisht, Kuvendi nuk i ka bërë asnjëherë publike veprimtaritë joparlamentare të kryera nga këta deputetë. Kjo ngre dyshime për efektivitetin e zbatimit të Kodit.</p> <p>Transparenca e veprimtarive të jashtme të deputetëve (çfarë pune, orarin dhe sa paguhet), është një aspekt i rëndësishëm i garantimit të llogaridhënies dhe integritetit në sistemin politik.</p>	<p>publiku mund të ndërgjegjësohet për çdo konflikt të mundshëm interesi në këto veprimtari, t'i mbajë deputetët përgjegjës për veprimet e tyre dhe të ketë më shumë besim se ata po veprojnë në interes të publikut dhe jo për përfitime personale.</p>
<p>LOBIMI</p>		
<p>NË LIDHJE ME LOBIMIN</p>	<p>Kodi i Sjelljes së Deputetit ndonëse parashikon akreditimin e lobistëve, grupeve të interesit dhe organizatave të shoqërisë civile në nivel parlamentar nuk rregullon plotësisht kontaktet e deputetëve me lobistët dhe palët e tjera të treta që kërkojnë të ndikojnë në procesin e ligjbërjes. Në praktikën tonë parlamentare nuk ka ndonjë ligj që trajton këtë çështje⁴.</p> <p>GRECO por edhe shoqëria civile ka theksuar mungesën e transparencës mbi ndikimin e sektorit privat në politikat e shtetit, projektet ose projektligjet dhe ka shprehur nevojën</p>	<p>a) Kuvendi mund dhe duhet të bëjë publike të gjitha kontaktet e deputetëve me lobistët, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit përfshirë kontaktet jashtë mbledhjeve të Kuvendit dhe komisioneve të tij.</p> <p>b) Kuvendi mund dhe duhet të investohet në rregullimin ligjor të lobimit (sikurse vendet e rajonit) duke përcaktuar</p> <ol style="list-style-type: none"> i. çfarë mund të konsiderohet qëllim legjitim i një aktiviteti lobist dhe kush mund të jetë lobues; transparencën e komunikimit mes lobistëve dhe zyrtarëve publikë ii. detyrimin për regjistrim të lobuesve në mënyrë që të zhvillojnë aktivitetet e tyre të lobimit; kufizimet pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës (periudha kohore e

⁴ Tek Udhërrëfyesi i Shtetit të së Drejtës kanë vendosur parashikimin për të hartuar një ligj të tillë brenda vitit 2027.

	për rregullimin ligjor të kësaj çështjeje sikurse në shumë vende të tjera përfshirë rajonin.	<p>caktuar p.sh. 2 vjet para se ish-zyrtari të mund të llobojë te institucioni ku ka punuar;</p> <p>iii. mbikëqyrje të vazhdueshme të aktiviteteve lobuese nëpërmjet strukturës së ngarkuar me administrimin e Regjistrimit të Lobimit për konstatimin e konflikteve të mundshme të interesit, hetimin e ankesave, shkeljeve dhe parregullsive, ofrimin e udhëzimeve dhe zhvillimin e trajnimeve për lobuesit dhe zyrtarët publikë si dhe organizimin e fushatave me qëllim ndërgjegjësimin e publikut;</p> <p>iv. sanksione për lobistët dhe zyrtarët publikë në rast shkeljeje të rregullave të lobimit etj.</p>
PROCESI LIGJVËNËS		
NË LIDHJE ME PROCEDURËN LIGJVËNËSE	Praktika e deritanishme parlamentare ka nxjerrë në pah edhe problematika në aspektin e cilësisë së ligjit si pasojë e shqyrtimit të tyre brenda një kohe shumë të shkurtër apo pengimit në pjesëmarrjen e duhur të palëve të interesuara në proceset legjislativë dhe debatet demokratike. Referuar standardeve europiane dhe praktikave të mira parlamentare procesi ligjvënës ndahet në tre lexime/faza: leximi i parë në parim - leximi i dytë nën për nën, dhe leximi i tretë në tërësi ku çdo fazë është e shkëputur në kohë dhe në procedurë nga fazat e tjera.	a) Të parashikohen procedura funksionale dhe efektive për shqyrtimin e ligjit duke sanksionuar ndarjen e procesit ligjvënës në tre lexime.
NË LIDHJE ME KONSOLIDIMIN E TEKSTEVE LIGJORE DHE INVENTARIZIMIN	Në Shqipëri, konsolidimi dhe inventarizimi i akteve ligjore nuk është ende i rregulluar . Konsolidimi i ligjit nënkupton integrimin në një akt të vetëm ligjor të të gjitha ndryshimeve	a) Kuvendi duhet të përfundojë procesin e konsolidimit dhe të iniciojë procesin e inventarizimit të ligjeve të cilat do të shërbejnë si burim i rëndësishëm referimi për institucionet ligjzbatuese, ekspertët dhe

<p>E LEGJISLACIONIT NË FUQI</p>	<p>dhe plotësimeve që ligji ka pësuar ndër vite. Një tekst ligjor i konsoliduar siguron më shumë transparencë dhe qasje më të lehtë (në ligj) duke qenë se përmban të gjitha ndryshimet ligjore që kanë amenduar tekstin bazë (PACEK).</p>	<p>studiuesit e së drejtës shqiptare, shoqërinë civile, grupet e interesit, bibliotekat publike apo të tjera të specializuara etj</p>
<p>NË LIDHJE ME MONITORIMIN E KUVENDIT NË NXJERRJEN DHE PËRMBUSHJEN E AKTEVE NËNLIGJORE</p>	<p>Hartimi i ligjit dhe mbikëqyrja e zbatimit të tij lidhet ngushtësisht dhe pazgjidhshmërisht me organin më të lartë ligjvënës, Kuvendin. Ndër të tjera, ky institucion duhet të sigurohet se legjislacioni sekondar është miratuar brenda afateve të përcaktuara prej tij dhe në përputhje me legjislacionin primar. Monitorimi në nxjerrjen dhe përmbushjen e akteve nënligjore mbetet një sfidë për Kuvendin.</p>	<p>a) Kuvendi mund dhe duhet të krijojë një mekanizëm për të monitoruar nxjerrjen dhe përmbushjen e akteve nënligjore. P.sh., një sistem online software i cili të mundësojë aksesin në kohë reale dhe komunikimin ndërinstitutional midis Kuvendit dhe institucioneve me detyrimin për ti nxjerrë ato do të ishte një zgjidhje.</p>

<p>NË LIDHJE ME BASHKËPUNIMIN DHE NDËRVEPRIMIN KUVEND – SHOQËRI CIVILE</p>	<p>Në praktikën tonë parlamentare, referuar Rregullores së Kuvendit (neni 68/2/1), nismat qeveritare në procedurë parlamentare supozohet ta kenë kaluar fazën e parë të konsultimit publik gjatë hartimit. Një konsultim i dytë i shërben përmirësimit të legjislacionit aq sa edhe shmangia e nismave të deputetëve nga ky proces e dëmton atë.</p> <p>Platforma e konsultimit publik: ajo shërben si një mjet lidhës komunikimi dhe konsultimi nëpërmjet së cilës ofrohet mundësia e komunikimit me shoqërinë civile, grupe interesi, grupime të tjera të interesuara apo individë për sa i përket tërheqjes së komenteve, mendimeve dhe sugjerimeve të tyre për përmbajtjen dhe përmirësimin e projektligjit dhe çështjeve të tjera të shtruara për konsultim.</p> <p>Konsultimi publik ka nevojë për fuqizim të mëtejshëm.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a) Kuvendi gjatë procesit të konsultimit publik duhet të bazohet jo vetëm në parimin e pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse dhe mosdiskriminimit në pjesëmarrje por mbi të gjitha në parimin e transparencës. Në respektim të këtij parimi, Kuvendi, duhet të bëjë transparente çdo mendim/sugjerim/rekomandim/shqetësim të subjekteve pjesëmarrëse në konsultimin publik si dhe të informojë publikun në mënyrë efektive; b) Kuvendi procesin e konsultimit publik nëpërmjet kësaj platforme, mund dhe duhet ta disiplinojë me akt të posaçëm, me rregulla të përcaktuara qartë lidhur me çështjet që do ti nënshtrohen konsultimit publik, subjektet pjesëmarrëse në konsultim, subjektet që autorizojnë këtë konsultim, afatin për dorëzimin e komenteve dhe rekomandimeve etj. c) Kuvendi, në mënyrë të detyrueshme, duhet t’ia nënshtrojë konsultimit publik, nismat ligjore të propozuara nga deputetët duke qenë se nuk ka një konsultim në fazat e hartimit të tyre; d) Takimeve publike me shoqërinë civile, grupe interesi apo individë të zgjedhur duhet ti jepet prioritet pasi ndikojnë në përmirësimin e nismave ligjore; e) Konsultimi publik online kërkon jo vetëm publikimin e nismës ligjore por edhe të ligjit të përditësuar për të cilin propozohen ndryshime.
<p>NË LIDHJE ME TË DREJTËN PËR DEBAT NË ZGJEDHJEN E KANDIDATURAVE PËR NË ORGANET</p>	<p>Nga monitorimi i kryer rezulton se shqyrtimi në seancë plenare reduktohet vetëm në votimin e kandidaturës duke anashkaluar komisionin përgjegjës dhe mbi të gjitha duke i mohuar deputetëve të drejtën për të diskutuar për këtë çështje.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a) Kuvendi ka të drejtën dhe detyrimin që t’ia nënshtrojë debatit parlamentar propozimet për në organet kushtetuese dhe/ose të krijuara me ligj. Diskutimet shërbejnë si një instrument që publiku të njohë më

KUSHTETUESE DHE TË KRIJUARA ME LIGJ	<p>Rregullorja ka përcaktuar në mënyrë taksative çështjet për të cilat nuk parashikohet debat dhe vetë termi “shqyrtim” nënkupton të drejtën dhe detyrimin e Kuvendit për ta bërë objekt diskutimi e debati çështjen në fjalë dhe për të marrë një vendim të caktuar për miratimin ose mosmiratimin e saj.</p>	<p>shumë kandidaturat e propozuara dhe të vlerësojë zgjedhjen ose jo të tyre në institucionin ku garojnë.</p>
NË LIDHJE ME TË DREJTËN PËR DEBAT NË SHQYRTIMIN E DEKRETEVE TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIM DHE SHKARKIM MINISTRI	<p>Nga të dhënat monitoruese rezultojnë se dekretet në fjalë nuk bëhen objekt diskutimi në seancë plenare me arsyetimin se këto dekrete i nënshtrohen vetëm votimit dhe jo diskutimit. Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 6, datë 18.1.2002 thekson <i>detyrimin e Kuvendit për të bërë objekt diskutimi e debati dekretin e Presidentit të Republikës dhe për të marrë një vendim të caktuar për miratimin ose mosmiratimin e tij.</i></p>	<p>a) Kuvendi ka të drejtën dhe detyrimin që t'ia nënshtrojë debatit parlamentar dekretet e Presidentit të Republikës për emërim dhe shkarkim ministri.</p>
MASAT DISIPLINORE		
NË LIDHJE ME REGJISTRIN E MASAVE DISIPLINORE	<p>Udhëzuesi i Detajuar për Sjelljen në Kuvend, pika 31, parashikon ngritjen dhe plotësimin e regjistrin të masave disiplinore me të dhënat për masat disiplinore të marra (edhe të legjislativave të kaluara). Nga të dhënat monitoruese rezultojnë se asnjë regjistër i tillë nuk është mbajtur dhe publikuar në faqen e Kuvendit.</p>	<p>a) Kuvendi mund dhe duhet të mbajë dhe të bëjë publike Regjistrin e Masave Disiplinore ndaj deputetëve. Transparenca rrit besimin e publikut tek parlamenti dhe promovon kulturën e llogaridhënies.</p>
NË LIDHJE ME DHËNIEN E MASAVE DISIPLINORE	<p>Pavarësisht kësaj, nga të dhënat monitoruese rezultojnë se parimi i trajtimit të barabartë (ndërmjet deputetëve të të gjithë spektrit politik) nuk ka gjetur respektim. Në mjaft raste</p>	<p>a) Organet përgjegjëse të Kuvendit duhet të aplikojnë masa disiplinore të njëjta për raste të njëjta, pavarësisht përkatësisë politike dhe pozitës së deputetit në Kuvend (kryeministër, ministër) duke</p>

	është konstatuar përdorimi i një gjuhe të pahijshme dhe joparlamentare, fyese apo kërcënuese nga Kryeministri, ministra apo deputetë të mazhorancës, megjithatë nuk janë marrë masa penalizuese.	vendosur gjithnjë prioritare etikën dhe parimet e sjelljes, si dhe interesin publik dhe vlerat e larta të parlamentarizmit.
NË LIDHJE ME LLOGARITJEN E MASËS DISIPLINORE “PËRJASHTIM NGA PJESËMARRJA NË SEANCË PLENARE/KOMISIONE”	Monitorimi i ISP tregon se janë ndjekur standarde të dyfishta lidhur me llogaritjen e afateve. (rasti AA u llogarit me ditë pune (sikurse parashikohet), ndërsa masa ndaj grupit të 23 deputetëve (dhe masat në vijim) u llogarit me ditë kalendarike).	a) Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën mund dhe duhet të saktësojë në dispozitivin e vendimeve <i>për dhënie mase disiplinore</i> , llogaritjen e masës me ditë pune sikurse parashikon neni 65/2 pika 4 e Rregullores së Kuvendit.
NË LIDHJE ME FORMALIZIMIN E MASËS DISIPLINORE “PËRJASHTIM NGA SEANCA PLENARE”	Të dhënat monitoruese tregojnë se ndonëse masa në fjalë është aplikuar shumë herë, ajo asnjëherë nuk është formalizuar me aktin juridik konkret të përcaktuar me Rregullore Kuvendi. Neni 7 pika 6 e Rregullores parashikon shprehimisht se <i>“Në ushtrim të funksioneve dhe kompetencave të tij, Kryetari i Kuvendit nxjerr urdhra dhe udhëzime”</i> .	a) Masa disiplinore “Përrjashtim nga seanca plenare” mund dhe duhet të formalizohet me aktin juridik përkatës (Urdhër).
MBI SUBJEKTET QË KANË TË DREJTË TË PARAQESIN ANKESA PËR SHKELJET E KODIT TË SJELLJES	Rregullorja e Kuvendit ndonëse ka parashikuar masat disiplinore për shkeljen e një pjesë të konsiderueshme të Kodit të Sjelljes nuk ka parashikuar subjektet që mund të paraqesin ankesën në raste të tilla. Për rastet e ngacmimit seksual të çfarëdolloj forme, të parashikuara në nenin 10 të Kodit të drejtën për të paraqitur ankesë e ka personi viktimë e ngacmimit seksual. Këtë të drejtë e kanë edhe të paktën 7 deputetë në rastet kur konstatojnë përdorimin e një gjuhe të pahijshme apo konfrontime fizike në punimet e Kuvendit ose	Rregullorja e Kuvendit mund të parashikojë subjektet që kanë të drejtën për ankesë në rastet e shkeljes së rregullave të Kodit të Sjelljes. E drejta për ankesë është një çështje delikate dhe që kërkon vëmendje pasi mungesa e saj çon në pamundësinë e zbatimit efektiv të Kodit dhe rrjedhimisht në mosndëshkueshmërinë e parlamentarit për shkeljen e këtyre rregullave.

	të organeve të tij. Në rastet e tjera, p.sh. për shkeljen e rregullave për lobimin, dhuratat, votimin për të tretët, Kodi apo Rregullorja nuk parashikojnë subjektin që ka të drejtën e paraqitjes së ankesës.	
BYROJA E KUVENDIT DHE PROCESI I ANKIMIMEVE NDAJ MASAVE DISIPLINORE	Rregullorja e Kuvendit (neni 65/4, pika 9) përcakton shprehimisht se <i>“nëse Byroja nuk mblidhet brenda afatit të përcaktuar (48 orë) masa disiplinore e dhënë mbetet në fuqi”</i> . Një parashikim i tillë (që lihet në vlerësimin e këtij organi) bie ndesh me të drejtën për ankimim dhe parashikimet e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me procesin e rregullt ligjor. Në respektim të standardit kushtetues për një proces të rregullt ligjor Byroja e Kuvendit ka detyrimin që pas paraqitjes së ankimit të fillojë menjëherë shqyrtimin e çështjes duke zhvilluar hetimin administrativ.	a) Rregullorja e Kuvendit mund dhe duhet të parashikojë në mënyrë taksative detyrimin e Byrosë së Kuvendit për të shqyrtuar ankesën e deputetit ndaj masës disiplinore të dhënë.
RREGULLAT E SJELLJES GJATË PUNIMEVE PARLAMENTARE		
NË LIDHJE ME VOTIMIN PËR TË TRETËT	Të dhënat monitoruese kanë zbuluar se votimi për të tretët praktikohet hapur në parlamentin shqiptar megjithëse karta elektronike e votimit sipas akteve të brendshme është personale dhe përdoret vetëm nga mbajtësi/titullari i saj. Pavarësisht se normat rregullatore parashikojnë masa ndëshkuese, këto të fundit nuk janë aplikuar në asnjërin prej rasteve të identifikuara.	a) Deputeti duhet të veprojë me mirëbesim dhe të zbatojë me rigorozitet dispozitat që rregullojnë procesin vendimmarrës. b) Drejtuesi i seancës plenare mund dhe duhet të ushtrojë kompetencën e tij në dhënien e masës disiplinore në rastet kur deputeti voton në emër të një kolegu tjetër i cili nuk është i pranishëm në sallë. c) Zbatimi i përcaktimit ligjor për një verifikim paraprak të kartave të votimit nga drejtuesi i seancës plenare do të shmangte këtë fenomen dhe do të rikthente legjitimitetin e vendimmarrjes së Kuvendit.

<p>NË LIDHJE ME PENGIMIN E DEPUTETËVE PËR PJESËMARRJE NË VOTIM</p>	<p>K ryerja nga deputeti, gjatë zhvillimit të procedurave vendimmarrëse, të veprimeve jokorrekte, me qëllim pengimin e kolegëve për të ushtruar të drejtën e votës sjell përgjegjësinë disiplinore të deputetit.</p> <p>Të dhënat monitoruese tregojnë se në shumë raste deputetë të pakicës parlamentare kanë ç’aktivizuar kartat elektronike të votimit të kolegëve të shumicës në sallën e seancave plenare duke pamundësuar pjesëmarrjen e tyre në votim.</p>	<p>a) Deputeti duhet të veprojë me mirëbesim dhe të zbatojë me rigorozitet dispozitat që rregullojnë procesin vendimmarrës.</p>
<p>NË LIDHJE ME SJELLJEN NË KUVEND</p>	<p>Në praktikë, debati gjatë punimeve parlamentare në seancë plenare, apo edhe në komisione, shpesh karakterizohet nga një mungesë e rregullave etike të komunikimit, duke u nisur nga gjuha denigruese dhe fyese deri tek përplasjet fizike, të cilat janë është bërë shkas për marrjen e masave disiplinore ndaj deputetëve.</p>	<p>a) Deputetët mund të kenë një qasje tjetër më institucionale, më serioze dhe më të përgjegjshme mbi rolin dhe përgjegjësitë e tyre kushtetuese. Sjellja etike është pjesë e identitetit personal dhe e sjelljes politike të çdo deputeti.</p> <p>b) Kuvendi mund të kërkojë nga deputetët, sidomos nga grupet parlamentare, që të aplikojnë standarde më të larta etike dhe që vetë grupet, të kenë mekanizma monitoruese, distancuese dhe parandaluese.</p>
<p>NË LIDHJE ME KODIN E VESHJES</p>	<p>Të dhënat e ISP tregojnë se rregullat e veshjes ndonjëherë nuk respektohen dhe në veçanti gratë deputete përdorin stile të papërshtatshme veshjeje me funksionin që mbajnë.</p>	<p>a) Deputeti mund dhe duhet të ruajnë solemnitetin dhe imazhin e institucionit më të lartë ligjvënës dhe të respektojë kodin e veshjes, për të siguruar publikun që parlamenti punon profesionalisht dhe përmbush detyrat e tij kushtetuese.</p> <p>b) Është përgjegjësi e drejtuesit të seancës dhe/ose e organit parlamentar ku deputeti merr pjesë që në rast konstatimi të një veshje të papërshtatshme të ftojë deputetin që të largohet dhe të përshtatë veshje</p>

<p>NË LIDHJE ME TË DREJTAT PROCEDURALE TË DEPUTETIT</p>	<p>Të dhënat monitoruese tregojnë se shpërdorimi që deputetët i bëjnë këtyre të drejtave procedurale ndodh shumë shpesh, sidomos gjatë punimeve parlamentare në seancë plenare. Keqpërdorimi i së drejtës për replikë apo i së drejtës për procedurë janë shpërdorime të besimit dhe sjellje të cilat nuk justifikohen se udhëhiqen nga interesi publik. Rregullorja ka përcaktuar qartë rastet se kur kërkohet fjala për procedurë dhe/ose replikë.</p>	<p>a) Deputeti duhet të veprojë me mirëbesim dhe të mos keqpërdorë të drejtat procedurale që i njeh Rregullorja e Kuvendit. Shpërdorimi i këtyre të drejtave sjell pasoja të dëmshme në zhvillimin e punimeve parlamentare.</p>
<p>PROCEDURAT PARLAMENTARE NË SEANCË PLENARE</p>		
<p>NË LIDHJE ME ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE VENDIMMARRËSE ME KARTONA</p>	<p>Votimi me kartona vë në pikëpyetje legjitimitetin e vendimmarrjes për sa kohë që nuk verifikohet kuorumi dhe shumica e kërkuar për miratim. Rezulton së në shumë raste Kuvendi ka marrë vendime pa kuorumin e kërkuar nga Kushtetuta.</p>	<p>a) Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën, si organ përgjegjës i Kuvendit që ndjek dhe mbikëqyr veprimtarinë procedurale të Kuvendit në seancë plenare, duhet ta trajtojë me seriozitet këtë çështje dhe të dokumentojë procesin vendimmarrës.</p> <p>b) Kuvendi, gjatë procedurave vendimmarrëse, mund dhe duhet të operojë gjithmonë me sistem elektronik. Zhvillimi i procesit vendimmarrës me këtë mënyrë votimi garanton zbatim korrekt të Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit.</p>
<p>NË LIDHJE ME SHQYRTIMIN NË SEANCË PLENARE TË DISA PROJEKTLIGJEVE TË PAPARASHIKUARA NË RENDIN E DITËS</p>	<p>Rregullat e procedurës (neni 31) lejojnë shqyrtimin e çështjeve të paplanifikuara në seancë plenare me kusht që të respektohen subjektet që bëjnë propozimin, fazën në të cilën bëhet propozimi, si dhe kuorumin e nevojshëm për votimin dhe miratimin e propozimit. Parashikueshmëria e çështjeve kontribuon për një diskutim cilësor dhe më të argumentuar aq sa edhe një shqyrtim i paplanifikuar i ligjeve në seancë plenare</p>	<p>a) Kuvendi, nuk duhet të krijojë praktika që bien ndesh me dispozitat e tjera të Rregullores. Procedura ligjvënëse e parashikuar me Rregullore përfshin një sërë rregullash që duhen ndjekur që nga depozitimi i projektligjit në Kuvend e deri në miratimin e tij në seancë plenare.</p>

	<p>kufizon debatin midis deputetëve, ndikon negativisht në cilësinë tij, kufizon të drejtën e deputetëve për të diskutuar dhe i privon ata nga vendimmarrja.</p> <p>Projektligjet kërkojnë diskutim të gjerë dhe për pasojë duhet të përjashtohen nga rrethi i çështjeve ku kjo dispozitë gjen zbatim.</p>	<p>Shqyrtimi i nismave ligjore sipas afateve dhe rregullave të parashikuara në Rregullore dhe akte të brendshme të Kuvendit ndihmon në cilësinë e legjislacionit.</p>
<p>NË LIDHJE ME DEBATIN PARLAMENTAR</p>	<p>Nga të dhënat monitoruese rezulton se debati nuk respekton rregullat e procedurës dhe që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e fjalimit parlamentar, respektimin e radhës së folësve dhe në veçanti, diskutimin brenda thelbit të çështjes. Seanca ndodhet shpesh para situatave të mungesës së dialogut midis forcave politike dhe për pasojë, të mosgjatjes së zgjidhjeve konsensuale.</p>	<p>a) Deputetët mund e duhet të kenë një qasje tjetër më institucionale, më serioze dhe më të përgjegjshme mbi rolin dhe përgjegjësitë e tyre kushtetuese.</p> <p>b) Është e nevojshme të rritet cilësia e debatit dhe niveli i argumentimit të fjalimeve të deputetëve në Kuvend. Rritja e informimit dhe njohurive mbi çështjet që diskutohen, si dhe përmirësimi i aftësive debatuese dhe oratorike të deputetëve mund të kontribuojnë ndjeshëm për debat më të mirë në Kuvend.</p> <p>c) Shfaqja e formave të ndryshme të mosrespektimit të kolegëve folës ose argumenteve të tyre mund të ndryshojë atmosferën eventuale korrekte, e cila është parakusht themelor për zhvillimin e debatit racional dhe argumentues. Njëkohësisht, kjo mund të ndryshojë rrjedhën e diskutimit dhe të cenojë punimet parlamentare ku situata të degradojë në sulme dhe fyerje, çka sjell pamundësinë e një debati thelbësor dhe konstruktiv.</p>
<p>MBLEDHJET E KOMISIONEVE</p>		
<p>NË LIDHJE ME ZHVILLIMIN E MBLEDHJEVE TË KOMISIONEVE</p>	<p>Rregulloren e Kuvendit (neni a/5) parashikuan zhvillimin e mbledhjeve në distancë, nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik, vetëm në rastet e masave të jashtëzakonshme, të</p>	<p>a) Kuvendi, si organi më i lartë përfaqësues dhe mbartësi i sovranitetit të popullit, duhet të dëshmojë vullnet, mençuri, tolerancë dhe lidhshmëri në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të krijuara dhe të ndërmarrë hapa</p>

<p>PARLAMENTARE ONLINE</p>	<p>vendosura për shkak të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësive natyrore.</p> <p>Kuvendi praktikoi përsëri këtë mënyrë funksionimi për sa i përket mbledhjeve të komisioneve parlamentare në kushtet e bllokimit të punimeve parlamentare nga opozita. Një praktikë e tillë bie në kundërshtim me përcaktimet e nenit a/5 të Rregullores së Kuvendit.</p>	<p>konkretë për të kthyer në normalitet veprimtarinë parlamentare. Zhvillimi i punimeve online nuk është mënyra e duhur për të zgjidhur situatën. Kuvendi, si institucioni kyç në sistemet demokratike të qeverisjes ka përgjegjësinë ligjore, politike dhe publike që të ofrojë standarde të larta integriteti, transparence dhe llogaridhënie institucionale.</p> <p>b)</p>
<p>TRANSPARENCA PARLAMENTARE</p>		
<p>NË LIDHJE ME TRANSPARENCËN PARLAMENTARE</p>	<p>Faqja në internet mbetet mekanizmi më i rëndësishëm për komunikim zyrtar me audiencat e jashtme dhe si e tillë duhet të pasurohet në mënyrë të vazhdueshme me informacione në funksion të informimit publik dhe qeverisjes së mirë dhe transparente.</p> <p>Avancimi i transparencës parlamentare siguron angazhim më të madh qytetar, Kuvend më të përgjegjshëm dhe një shoqëri më demokratike. Sikurse ka theksuar edhe Komisioni Europian përmirësime të mëtejshme mbeten të nevojshme për të siguruar disponueshmëri publike më në kohë dhe miqësore për përdoruesit e dokumentacionit zyrtar parlamentar për shoqërinë civile, median, palët e tjera të interesuara dhe publikun më të gjerë.</p>	<p>a) Informacioni parlamentar i publikuar përbën një aspekt kyç të veprimtarisë parlamentare dhe prezantimit të saj prandaj rekomandohet të jetë i kuptueshëm dhe <u>vizualisht më estetik</u>, e për rrjedhojë do të jetë edhe më i lexueshëm nga publiku dhe grupet e interesuara.</p> <p>b) Kuvendi mund dhe duhet të bëjë ndryshime cilësore në faqen on line dhe në adresimet e tjera online, në mënyrë që media e qytetarët e interesuar të kenë në çdo kohë informacionet të cilat referuar kuadrit ligjor janë të detyrueshme për publikim.</p> <p>c) Vendosja e pyetjeve të qytetarëve dhe në veçanti e përgjigjeve të Kuvendit, në faqen e këtij të fundit në internet, do të ndihmonte publikun drejt informimit më të mirë për punën e deputetëve, do të afrojë ata me zgjedhësit dhe do të rrisë besueshmërinë tek organi ligjvënës.</p>

- d) Kuvendi mund të bëjë publik informacionin për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, që përfshijnë: listën e kontratave të lidhura; shumën e kontraktuar; palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara etj referuar nenit 7, pika 1 germa “e” të ligjit “Për të drejtën e informimit”.
- e) Kuvendi mund të vendosë në dispozicion të publikut informacione të mjaftueshme për t’i dhënë mundësi qytetarëve që të gjykojnë lidhur me integritetin dhe ndershmërinë e deputetëve. Këto informacione duhet të përfshijnë deklaratimet e pasurisë, të dhuratave apo përfitimeve të ngjashme të marra gjatë detyrës, shpenzimet e tyre parlamentare, si dhe përfitime të tjera. Ngjashëm transparente duhet të bëhen edhe marrëdhëniet e deputetit me lobistët dhe organizatat e shoqërisë civile ose grupet e interesit.
- f) Kuvendi mund të angazhohet në konsultime me opinionin e përgjithshëm dhe organizatat e shoqërisë civile që monitorojnë parlamentin për të nxitur monitorim efektiv dhe evitimin e pengesave për qasje në informacionin parlamentar.
- g) Kuvendi mund të fillojë zbatimin e sistemit të petitionit elektronik (e-petitioning). Peticionet elektronike janë një mekanizëm thelbësor drejt hapjes institucionale, pjesëmarrjes dhe angazhimit qytetar. Rekomandohet që Kuvendi të qaset drejt sistemeve të tilla në kuadër të nismës “Partneritet për qeverisje të hapur”.

- h) Një element tjetër që kontribuon në transparencën e Kuvendit është edhe përcaktimi i statusit në shqyrtimin e projektligjeve. Me status kuptojmë ecurinë e shqyrtimit të tyre e cila u mundëson qytetarëve të përfshihen më shumë në procesin legjislativ.
- i) Kuvendi duhet t'i japë rëndësi publikimit të informacionit parlamentar në formatin XML e strukturuar. Ky format, duke qenë se është i lexueshëm dhe i përpunueshëm nga kompjuterët, mundëson ripërdorimin e informacionit parlamentar nga qytetarët, shoqëria civile, dhe persona të tjerë të interesuar.
- j) Kuvendi duhet të sigurojë që gjuha juridike apo teknike të mos shërbejë si pengesë për qytetarët që kërkojnë qasje në informacionin parlamentar. Pavarësisht domosdoshmërisë së përdorimit të terminologjisë juridike në hartimin e ligjeve, Kuvendi duhet të hartojë përmbledhje të informacionit në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për deputetët dhe qytetarët.
- k) Kuvendi mund dhe duhet të sigurojë gjetje të shpejtë të informacionit për qytetarët duke krijuar baza të të dhënave e duke mundësuar kërkime të thjeshta dhe komplekse përmes përdorimit të metatave të duhura.
- l) Kuvendi mund dhe duhet të bëjë përpjekje që të përmirësojë mënyrën e publikimit të informacionit duke e lidhur këtë të fundit me informacione të tjera përkatëse psh publikimi i projektligjit të jetë i lidhur me publikimin e tekstit të konsoliduar të ligjit në fuqi,

raporti i komisionit parlamentar të jetë i lidhur me debatin në komision etj.

- m) Kuvendi duhet të zhvillojë veprimtarinë e botimeve me materiale informuese që pasqyrojnë veprimtarinë e Kuvendit, sidomos ato në kuadër të edukimit qytetar, si broshura, manual, fletëpalosje, doracak etj
- n) Kuvendi duhet të krijojë mekanizma për matjen e perceptimit të publikut në lidhje me nivelin e transparencës së Kuvendit (si p.sh. zhvillimi i anketimeve) pasi ato ndikojnë për promovimin e veprimtarisë së Kuvendit.
- o) Kuvendi mund dhe duhet të bëjë publike aktivitetin parlamentar të çdo deputeti për të vlerësuar performancën e tij në Kuvend. Nëpërmjet kësaj evidentohen deputetët produktiv dhe me një aktivitet të gjerë parlamentar. Kjo shërben jo vetëm si model referimi për deputetët e tjerë por edhe si notë përcaktuese e zgjedhësve për zgjedhjet e ardhshme parlamentare.